

VENDIM
Nr. 550, datë 28.9.2023

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIM RRUGA LIDHËSE E AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR
TË VLORËS (VIA), AUTOSTRADA FIER–VLORË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim rruga lidhëse e aeroportit ndërkombëtar të Vlorës (VIA), autostrada Fier–Vlorë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë” dhe “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 957 852 (nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 957 852 (nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e dy) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Vlorë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE E TË CILËVE PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PUBLIK “NDËRTIM RRUGA LIDHËSE E AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË VLORËS (VIA) AUTOSTRADA FIER–VLORË”

Nr. rendor	Pronari	Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Vlerësimet për shpronësim				Adresa	Shënime
	Emri i pronarit	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale	Sip. e shpronësimit (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Vlera totale (lekë)		
1	Thimi Hyso	2813	146/1	arë	5200	456	204	93024	93,024.0	Novoselë	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Vllasi Hyso	2813	136/1	arë	2000	349	204	71196	71,196.0	Novoselë	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	Nije Llambro Kozma Llambro Natasha Llambro Entela Llambro Arberjan Llambro Eliona Llambro Gjenea Llambro	2813	148/1	arë	7800	434	204	88536	88,536.0	Novoselë	Konfirmuar nga ASHK-ja
4	Kristaq Moçka	2813	132/32	arë	1200	920	204	187680	187,680.0	Novoselë	Konfirmuar nga ASHK-ja
5	Mihallaq Dhomi Buzi	2813	123/1	arë	5244	462	204	94248	94,248.0	Novoselë	Konfirmuar nga ASHK-ja
6	Aleko Llanaj	2813	147/37	truall	3354	237	384	91008	91,008.0	Novoselë	Konfirmuar nga ASHK-ja. Mbi këtë truall ngrihet pasuria 147/37 ND, V.19, f. 28
7	Kastriot Sinanaj	2813	124/16	truall	8840	398	384	152832	152,832.0	Novoselë	Konfirmuar nga ASHK-ja
8	Shoq. Azurra Imobilare	2813	124/17	truall	1160	49	384	18816	18,816.0	Novoselë	Konfirmuar nga ASHK-ja
9	Shoq. Azurra Imobilare	2813	124/11	truall	8000	378	384	145152	145,152.0	Novoselë	Konfirmuar nga ASHK-ja
10	Shoq. Azurra Imobilare	2813	124/12	truall	730	40	384	15360	15,360.0	Novoselë	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Vlera totale					3723		957,852	957,852.0		